

**Akademik Beqir Meta**

**PARLAMENTI DHE SHTETNDËRTIMI NË SHQIPËRI  
NË VITET 1920-1924**

(Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Parlamentarizmi shqiptar ndër vite", Prizren, 2021)

Kongresi i Lushnjes miratoi një Kushtetutë embrionale, e cila sanksiononte në thelb një regjim parlamentar të pastër, ku parlamenti kishte prerogativa shumë të gjera. Në aspektin e progresit, lirisë dhe demokracisë, sanksionimi i një parlamenti të tillë ishte tepër i dëshirueshëm dhe madje ngazëllyes. Ky vendim dëshmonte dëshirën iluministe të elitës drejtuese të asaj kohe për të ndërtuar një shtet modern dhe demokratik. Ky eksperiment tepër i guximshëm, por njëkohësisht edhe naiv drejt demokracisë, përgjithësisht është vlerësuar lart në historiografinë shqiptare të gjitha periudhave. Edhe ne sot, 100 vite më pas, e shohim atë me admirim dhe krenari. Krijimi i parlamentit të parë shqiptar funksional dhe efektiv, përkon me fillesat e procesit të shtetndërtimit në Shqipëri. Ndryshe nga shumë vende të tjera në botë ku krijimi i një parlamenti demokratik kishte ndodhur pas një procesi relativisht të gjatë shtet-ndërtues, ku ishin krijuar institucione qeverisëse me tradita, të cilat kishin siguruar stabilitet, ishin provuar si efektive dhe ishin bërë pjesë e kulturës politike të popullit, parlamenti shqiptar demokratik nuk trashëgoi një përvojë të tillë. Kjo në vetvete ishte një ndër sfidat më të mëdha të parlamentit shqiptar, 100 vite më parë.

Kështu ai ka meritën se vuri themelet ligjore të shtetit të ri shqiptar. Arritja më madhore, pas Bazave të Kanunores të miratuara nga Kongresi i Lushnjes, ishte miratimi i “Zgjanimit të Statutit të Lushnjes” në dhjetor 1922, që ishte një kushtetutë gati e plotë, moderne, demokratike dhe tepër e përparuar për kohën. Ajo përbën krenarinë konstitucionale shqiptare për shekullin e XX.

Por këtu duhet nënvizuar fakti që nuk është vlerësuar deri më sot, se Bazat e Kanunores, duke qenë një dokument i shkurtër embrional kushtetues, vetëm me 6 nene, nuk krijonte mundësi për mirorganizimin e shtetit mbi baza normale ligjore. Për më tepër, kjo detyrë nuk u plotësua as nga Këshilli Kombëtar që zgjodhi Kongresi i Lushnjes, i cili funksionoi deri në dhjetor të vitit 1920. Gjithashtu edhe Parlamenti i konstituuar nga zgjedhjet e rregullta politike të vitit 1921 e hartoi

shumë vonë, gati dy vjet pas zgjedhjes së tij, Statutin e Zgjeruar që përmendëm më lart. Kështu këto tre institucione ligjvënëse shqiptare, duke e vonuar shumë hartimin e një kushtetute provizore që do të shtrinte juridiksionin e saj derisa të mblidhej Asambleja Kushtetuese, e cila do të hartonte Kushtetutën definitive, krijuan vështirësi të shumta ligjore e politike në organizimin e institucioneve shtetërore. Kjo flet për kapacitetet e ulëta shtet-formuese të elitës shqiptare të kohës, gjë që pati pasoja negative në funksionimin e stabilizimin e shtetit shqiptar.

Megjithatë, Parlamentet e viteve 1920 dhe 1921-1923 nxorën një sërë ligjesh dhe vendimesh të rëndësishme, të cilat kemi pasur kënaqësinë t'ia paraqesim të plota opinionit shqiptar në një botim dokumentar voluminoz të realizuar në vitin 2019. Ato përbëjnë sendërtimin e jetës shtetërore në të gjitha sferat: politike, ekonomike, juridike, sociale, kulturore, arsimore, religjioze, të komunikacioneve etj.

Në sferën ekonomike parlamenti miratoi ligje që avanconin në mënyrë të moderuar përpara ekonominë shqiptare drejt përafrimit me një ekonomi kapitaliste. Arritje e shënuar në këtë drejtim ishte miratimi i “kontratës tip”, e cila detyronte pronarët e tokave të mos dëbonin ose cenonin bujqit qiramarrës, nëse këta të fundit shlyenin detyrimet kontraktuale ndaj tyre. Ky ishte një hap i moderuar, por me shumë rëndësi për kohën, pasi ky ligj u kundërvihet arbitrariteteve të pronarëve, aq të përhapura në atë kohë, dhe inkurajonte marrëdhëniet kapitaliste në fshat.

Në sferën juridike, ai bëri ndryshime me rëndësi në kodet e mëparshme civile penale të trashëguara nga periudha osmane dhe, mbi të gjitha, krijoi një sistem efektiv gjyqësor, i cili dha një kontribut të madh në paqtimin e vendit, me jetësimin e lirive dhe të drejtave juridike të qytetarëve dhe krijimin e besimit tek popullsia për funksionimin e shtetit në bazë të ligjeve.

Në sferën kulturore dhe arsimore, ai krijoi bazat ligjore të zhvillimit të një arsimit dhe kulture me përmbajtje e shpirt kombëtar dhe me orientim progresiv. Meqë jemi në sferën e kulturës, duhet të theksojmë edhe diçka tjetër themelore: Megjithëse ballafaqimet politike në këtë kuvend ishin të ashpra dhe nganjëherë konfliktuale, gjuha e komunikimit në debatet parlamentare mbeti vendosmërisht e kulturuar, brenda normave të etikës qytetare e zyrtare. Kjo është një vlerë tjetër e këtij parlamenti që mbetet frymëzuese për sot.

Në sferën e komunikimeve, parlamenti shqiptar miratoi akte me rëndësi, që e bënë Shqipërinë pjesëtare të rrjetit botëror të komunikacioneve, duke ndihmuar në hapjen e saj drejt botës.

Por, përveç këtyre kontributeve për vendosjen e themeleve të shtetit, që janë me rëndësi historike, Parlamenti i parë dëshmoi edhe limitet e veta dhe përgjithësisht limitet e shoqërisë shqiptare të asaj kohe.

Sfida kryesore e humbur e këtij Parlamenti, si dhe të gjithë sistemit politik dhe të elitës drejtuese të asaj kohe, ishte stabilizimi i shtetit. Parlamenti shqiptar nuk arriti të krijonte një qeverisje të stabilizuar në vend. Përkundrazi ai u bë arenë e përplasjeve të ashpra politike, të cilat dolën edhe përtej suazave parlamentare dhe tronditën themelet e shtetit. Kjo ishte një mangësi dhe dështim i dhimbshëm në procesin e shtet-ndërtimit, i cili në ato vite ishte detyra më madhore, prioriteti i vetëm i të gjitha prioriteteve të shqiptarëve.

Mbledhja e Asamblesë Kushtetuese që do të hartonte kushtetutën përfundimtare u shty deri në janar të vitit 1924, për shkak të rrethanave të pafavorshme që bënë të pamundur mbledhjen e saj, të cilat lidheshin me përcaktimin me vonesë të statusit ndërkombëtar të shtetit shqiptar (i cili u sanksionua në nëntor 1921 me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve) dhe të kufijve të tij. Por edhe më tragjik ishte fakti se edhe kur Asambleja Kushtetuese u mbledh, për shkak se politikanët shqiptar të kohës kishin vendosur si prioritet të veprimtarisë së tyre ardhjen në pushtet dhe jo miratimin e kushtetutës, ajo dështoi tërësisht. Ajo nuk arriti as të hartonte një draft të kushtetutës dhe as që të diskutonte rreth saj.

Gjatë kësaj periudhe ndodhën kriza të thella që vunë në pikëpyetje shtetin dhe pavarësinë e vendit. Të tilla ishin: grushti i shtetit i dhjetorit 1921; Kryengritja antiqeveritare e marsit 1922; tentativa për grusht shteti dhe për vrasjen e kryeministrit më 28 nëntor 1923; tentativa për vrasjen e kryeministrit në shkurt 1924; vrasja e deputetit Avni Rustemi në maj 1924 dhe kryengritja e qershorit 1924, e cila i dha fund ekzistencës së një parlamenti që funksiononte mbi parime demokratike në Shqipëri.

Pasi kemi studiuar gjerësisht burimet shqiptare dhe të huaja, veçanërisht të diplomatëve perëndimorë në Shqipëri, si dhe veprat e shumta të shkruara nga studiues vendas e të huaj, kemi arritur në përfundimin se shkaqet e këtij dështimi ishin:

1. Gjendja e përgjithshme arsimore, kulturore, e përvojës politike të shoqërisë shqiptare të asaj kohe, mungesa e përvojës në jetën shtetërore, gjendja e vështirë ekonomike e saj etj. Vëzhguesit e huaj, thuajse të gjithë, i nënvizonin këto mangësi dhe konstatonin mungesën e pjesëmarrjes së popullsisë së thjeshtë në procesin politik, të cilën e konsideronin si themelore për funksionimin e një demokracie parlamentare.

2. Niveli dhe kapacitetet politike shtet-formuese të ulëta të elitës politike drejtuese të vendit. Mungesa e idealizmit politik të kësaj elite në atë nivel që kërkonte shtet-formimi. Paaftësia e saj për të kuptuar nevojat themelore të vendit dhe, mbi të gjitha, paaftësia e saj për t'ua nënshtruar interesat e saj të ngushta politike dhe ambicien për pushtet, interesave më të gjera dhe madhore të shtetit. Lidhur me këtë, Legata Britanike pohonte se për këta politikanë “homazhi ndaj idealeve perëndimore të demokracisë, që ka të bëjë me respektimin e metodave parlamentare të opozicionit, ishte i parakohshëm në Shqipëri.<sup>1</sup> Ndërsa ne shtojmë se edhe kuptimi i tyre për shtetin dhe institucionet shtetërore, si garanci e jetës sovrane të kombit, ishin të mangëta.

Gjatë viteve të punës hulumtuese për ne si historianë ishte disi e pashpjegueshme kur shihnim se intelektualë me emër të asaj kohe ose patriotë që kishin dhënë një kontribut të çmuar në Lëvizjen Kombëtare dhe në pavarësinë e Shqipërisë, demonstroi tendenca të tilla konfliktuale, partikulariste, klanore ose krahinore, pa marrë parasysh se cenoheshin interesat madhore të vendit dhe stabiliteti i tij. Diplomatët e huaj në Shqipëri vinin në dukje se Shqipëria kishte një popullsi të paarsimuar, nga e cila u formua një klasë politike e paditur që përbëhej nga persona të dhënë më tepër pas intrigave se sa pas elektoratit të tyre. Dhoma e Parlamentit u bë një skenë grindjesh mes deputetëve të cilët kishin si pikësynim vetëm interesat e tyre personale.<sup>2</sup>

Një problem themelor ishte papërshtatshmëria e formës së regjimit politik të shtetit që përcaktoi Kongresi i Lushnjës në raport me kapacitetet shtet-formuese e politike të popullsisë dhe të elitës politike të vendit. Kjo mospërputhje ndikonte fuqishëm në procesin e krijimit të institucioneve efektive dhe të forta. Edhe revista prestigjioze britanike “The Near East” evidentonte formën e papërshtatshme të regjimit politik në Shqipëri, si dhe rolin negativ në këtë situatë qeverisëse të

---

<sup>1</sup> TNA, FO 371/7330, f. 581-586; Heathcote Smith për Lordin Curzon të Kladestonit, 18 janar 1922.

<sup>2</sup> TNA, FO, 371/9644, Eyres për MacDonald, 10 qershor 1924.

grupit kryesor qeverisës të Partisë Popullore, ose siç quhej nga kundërshtarët e saj politik, “Klikës”. Ajo shkruante: “Të përpiqesh për pavarësinë është një gjë, por për të formuar qeverinë, për të organizuar shtetin dhe për të krijuar një komb kompakt dhe efektiv, është diçka tjetër. Çdo vështirësi qëndron tek administratorët e tij (qeveritarët dhe deputetët). Duke i shtuar këto vështirësi, delegatët që u mblodhën në Kongresin e Lushnjës për të vendosur kushtetutën, ia dhanë pushtetin suprem katër regjentëve, krijuan qeverinë dhe parlamentin me një dhomë. Këto, në duar pa eksperiencën dhe pa përvojën e duhur, u bënë të komplikuar dhe të paefektshme. Për të organizuar dhe qeverisur një shtet në këto kushte kërkohen administratorë të zotë, të ndershëm dhe me përvojë. Gjatë katër viteve të fundit Shqipëria ka dështuar në krijimin e tyre.”<sup>3</sup>

3- Parë në këto rrethana, sistemi politik, pra regjimi i pastër parlamentar, që u aplikua në Shqipëri, ndonëse demokratik nga pikëpamja konstitucionale, ai nuk ishte i përshtatshëm për Shqipërinë e asaj kohe. Ministri britanik, Harry Eyres, shkruante: “Patriotët shqiptarë në Lushnjë, fatkeqësisht u infektuan me virusin e qeverisjes parlamentare, i cili do të zëvendësonte atë të Lindjes. Është për të ardhur keq që sistemi përfaqësues i një vendi, i cili është kampion i institucioneve të lira (Eyres këtu kishte parasysh Britaninë e Madhe) të mund të aplikohet në vende myslimane të cilat, në kundërshtim me eksperiencat e Perëndimit, nuk kanë kaluar një evolucion politik përgjatë shekujve. Idetë e qeverisjes së tyre janë të kundërta me ato të Perëndimit dhe një sistem i tillë do të sjellë gjithmonë fatkeqësi”.<sup>4</sup>

Edhe Foreign Office, në përfundim të ngjarjeve të viteve 1920-1924, jepte një vlerësim negativ për rezultatet e procesit politik të kësaj periudhe në Shqipëri dhe arrinte në përfundimin se “Shqipëria nuk mund të drejtonte vetëm”. Prandaj parashikonte tre opsione të mundshme për të ardhmen e Shqipërisë: a) copëtimin e saj midis Italisë, Serbisë e Greqisë; b) vendosjen e një mandati italian; c) vendosjen nën kontrollin e plotë të Lidhjes së Kombeve, që konsiderohej si zgjidhja më e mirë.<sup>5</sup>

---

<sup>3</sup> TNA, FO 371/9644; Kopurë e gazetës “The Near East”, korrik 1924.

<sup>4</sup> TNA, FO 371/9644, Eyres për MacDonald, 10 qershor 1924

<sup>5</sup> TNA, FO 371/10654/C217/52/90, Memorandum i Central Department në Foreign Office, 5 janar 1924. Në këtë dokument, ndër të tjera theksohej se ngjarjet që kishin ndodhur ishin dëshmi e qartë se “Shqipëria nuk i është përkushtuar konceptit të qeverisjes. Përfaqësimi i shqiptarëve në institucione është jo i plotë, idetë për unitet kombëtar janë të nivelit fillestar dhe nëse lihen pa mbikëqyrje, ekzistojnë tendenca konfliktuale të brendshme. Popullsia ndahet në gegë e toskë, ekzistojnë tre religjione... Mungesa e unitetit social dhe ekonomik është rezultat i bashkëzistencës së tre faktorëve konfliktualë të civilizimit – klanet e malësorëve në veri, pronarët feudalë të tokave në qendër dhe popullsia më e arsimuar dhe edukuar e racës helenike (ortodokse shqiptare) në jug. Këtyre

4- Parlamenti i parë shqiptar, si dhe e gjithë qeverisja, ishte e detyruar të bashkëjetonte me fuqitë personale të armatosura të cilët *de facto* ekzistonin në vend.

Lider të fuqishëm brenda maxhorancave ose opozitave të kësaj kohe i dispononin këto, dhe në raste konfliktesh politike i kanë përdorur hapur ato për të realizuar synimet e pushtetit. Kjo sigurisht e cenonte rëndë funksionimin, efektivitetin dhe rolin e parlamentit. Siç shpreheshin diplomatët britanikë, kjo e shndërronte parlamentin e parlamentarizmin në një lëvozhgë të demokracisë, pasi fuqia reale e një politikani nuk matej me votat që fitonte, por nga sasia e armëve që kishte në dispozicion.

5- Sistemi politik ishte i tillë saqë krerët e grupeve politike të mëdha ose më të vogla bënë ligjin. Deputetët përgjithësisht në vend, që t'i bindeshin ndërgjegjes së tyre e interesave legjitime të elektoratit, e kishin shitur besnikërinë e tyre tek këta lider që i kishin caktuar në listat e tyre elektorale. Kjo i kthente ata përgjithësisht në marioneta politike.

6- Jeta normale parlamentare dhe stabiliteti institucional politik u cenuan edhe nga një defekt tjetër i madh i një pjese të konsiderueshme të politikanëve shqiptar. Ata krijuan lidhje personale me shtete të huaja, me qëllim që të përforconin pozitat dhe objektivat e tyre politike në Shqipëri, përkundrejt rivalëve të tyre politikë. Ndërsa këto shtete luajtën me ta dhe i përdorën në interesin e tyre për të krijuar influenca e dominim në politikën shqiptare, të cilat në të shumtën e herës qenë në dëm të interesave kombëtare shqiptare dhe të stabilizimit të vendit. Kjo e rriti konfliktualitetin në vend dhe ishte faktor madhor në stimulimin e krizave të rënda politike.

7- Një ndikim në situatën konfliktuale në parlament dhe jo vetëm ka pasur një lloj asimetrie dhe disbalance në fuqinë dhe organizimin e forcave politike. Dominimin politik në këto vite e ka pasur një organizatë e fshehtë politike e quajtur “Krahu Kombëtar”. Ajo luajti një rol të madh pozitiv në restaurimin e pavarësisë së Shqipërisë, në organizimin e Kongresit të Lushnjës, ishte forcë kryesore në qeverinë e S. Delvinës gjatë vitit 1920, pati një raport jo shumë të qartë me pushtetin në vitin 1921 dhe ishte sunduese në vitet 1922-1923, deri kur u shpërbë dhe degjeneroi

---

vështirësive duhet t'u shtohet edhe xhelozia e shteteve fqinje dhe paaftësia e shqiptarëve të rëndomtë të absorbojnë diçka nga kultura perëndimore... Si rezultat i këtyre rrethanave, Shqipëria sot ndodhet në një gjendje kaosi të plotë ekonomik, politik e financiar”.

në grupe rivale të brendshme, të cilat përdorën çdo mjet, duke përfshirë korrupsionin, intrigat dhe grushtet e shtetit, për të marrë në dorë fuqinë. Në etapën e parë, në vitet 1920-1921, grupet opozitare në Parlament ishin të përçara dhe më të dobëta. Kjo situatë midis dy blloqeve e reflektua në një klimë të tensionuar politike. Ndërsa në vitin 1923-1924 kur kjo organizatë, e cila nga kundërshtarët emërtohej “Klika”, u çua nga brenda në mënyrë të pariparueshme, pjesa e saj që nuk arriti të fitonte shumicën në zgjedhjet e vitit 1923, u bashkua me ish opozitën e mëparshme dhe organizoi Kryengritjen e Qershorit 1924.

Pas kësaj analize institucionale shtrohet pyetja: A e fitoi parlamenti i parë shqiptar sfidën me historinë në procesin e sendërtimit të shtetit shqiptar? Rezultatet e arritura nuk na lejojnë që të japim një përgjigje të prerë po ose jo.

Sigurisht Kongresi i Lushnjes që funksionoi si një parlament themeltar si një Asamble Kombëtare e rikrijoi shtetin kombëtar shqiptar me institucione që kopjonin modelin progresiv të shteteve në shekullin e XX. Gjithashtu këto institucione kishin edhe dy cilësi të tjera të admirueshme: ato ishin krijuar vetëm me kontributin e shqiptarëve dhe nuk u nënshtroheshin ndërhyrjeve apo kushtëzimeve institucionale të huaja, ndonëse duhet shtuar se ato ishin nën një presion të fortë të jashtëm që vinte kryesisht nga fqinjët, veçanërisht nga Italia, por edhe nga shtete e faktorë të tjerë. Me gjithë vështirësitë dhe dështimet shteti shqiptar në këtë fazë të parë të ekzistencës ekzistoi dhe u afirmua si një entitet politik.

Nëse do ta shikojmë kontributin e Kongresit të Lushnjes, të Senatit ose Këshillit Kombëtar të dalë prej tij, dhe të parlamentit të parë shqiptar të dalë nga zgjedhjet politike të vitit 1921, në këndvështrimin e stabilizimit të shtetit shqiptar, efektivitetit të institucioneve politike e më gjerë, të forcimit e stabilizimit të shtetit, krijimit të paqes sociale në vend, zhvillimit ekonomik, përgjigjja do të ishte me siguri – Jo.

Por përtej kësaj ne duhet të shohim edhe kontributin e parlamentit në emancipimin e përgjithshëm të shoqërisë shqiptare. Në këtë këndvështrim, që nuk është më pak i rëndësishëm, ne mund të konstatojmë se parlamenti i parë shqiptar filloi një proces historik me rëndësi dhe me pasoja të jashtëzakonshme për shoqërinë shqiptare.

Ai ishte institucioni themelor politik, promotori kryesor dhe më i fuqishëm për ta drejtuar shoqërinë shqiptare drejt jetës shtetërore të përbashkët dhe njëkohësisht drejt “Oksidentit”. Edhe pse po vepronte në një terren jashtëzakonisht të vështirë, ky parlament la gjurmë në ndërgjegjen shqiptare si një sprovë titanike, me plot sakrifica për të ecur në një rrugë e cila ishte e vetmja drejt progresit dhe prosperitetit.

Parlamenti i parë shqiptar ishte kontrollues efektiv i qeverisë dhe qeverisjes, ai promovoi dhe u bë garant i të drejtave themelore të njeriut. Përgjithësisht ai i mbrojti këto liri në një shkallë të admirueshme në raport me nivelin dhe mundësitë e shoqërisë shqiptare të asaj kohe. Liria e fjalës, e shtypit, e zgjedhjeve, e pronës, e besimit, e konkurrencës politike, e lëvizjes dhe një sërë lirish të tjera në ato katër vite të jashtëzakonshme në historinë e Shqipërisë, ishin në një nga nivelet e larta në Evropën Lindore e Juglindore. Krahasuar me shtetet fqinje ballkanike, qeveritë e viteve 1920-1923 ishin më demokratiket, me gjithë mangësitë e tyre.

Impresionues ishte zhvillimi i shtypit shqiptar, ndërmarrja e reformave të mëdha në sferën e institucioneve religjioze, duke siguruar lirinë e besimit, shkëputjen e tyre nga politika, shkëputjen nga varësia prej qendrave të jashtme, ndërtimi i tyre si institucione të pavarura kombëtare që ishin në harmoni me shtetin shqiptar dhe siguronin harmoninë e vëllazërinë midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme. Parlamenti shqiptar dha një kontribut themelor historik në këtë drejtim, duke shtruar trasenë e një zhvillimi në rrugë të drejtë e progresive. Kjo nuk ishte e lehtë. Ai përballoi sfida të mëdha që vinin nga e kaluara, si dhe presione të forta politike nga jashtë.

Një arritje tjetër që e bëri shtetin dhe parlamentin e parë liberal dhe me orientim progresiv ishin liritë dhe të drejtat që iu akorduan pakicave. Ato ishin krenaria e shtetit të ri shqiptar, e cila mori vlerësimin në organizmat ndërkombëtare dhe i shërbyen konsolidimit dhe stabilizimit të tij.

Diskutimet nga ky parlament për emancipimin e femrës shqiptare, ishin nga më mbresëlënëset. Në këtë mënyrë ai çeli rrugën drejt emancipimit të saj, përmirësimit të pozitave sociale, juridike e ekonomike, arsimimit dhe kulturës. Sigurisht në atë kohë arritjet ishin jo substanciale, por tashmë procesi kishte filluar dhe me gjithë vështirësitë e mëdha, ai do të çante përpara.